



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Kompania Regjionale e MbeturinaVe/ Regional Waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada
KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/327-501, 0290/325-025



RAPORTI VJETOR I PUNËS 2023

Ferizaj, Janar 2024

Përmbajtja

HYRJE	1
1. TË HYRAT	2
2. INKASIMI	4
3. SHPENZIMET	8
4. LLOGARITË E PAGUESHME	15
4.1 STOQET	19
5. TË DHËNAT NGA OPERATIVA	20
6. BURIMET NJERËZORE	22
6.1 ZYRA LIGJORE	24
7. ZYRA E PROKURIMIT	24

HYRJE

Bazuar në statutin e KRM “Pastërtia” Sh.A. si dhe në rregulloren e punës së kompanisë, lidhur me hartimin e raporteve vjetore të punës, KRM “Pastërtia” Sh.A. vazhdon punën e vetë në kryrjen e shërbimeve, mbledhjen e mbeturinave dhe deponimin e tyre në deponi.

Ne databazën e KRM “Pastërtia” Sh.A. deri në fund të vitit 2023 gjendeshin të regjistruar 32,343 klientë aktiv, ku një pjesë prej 6,227 klientëve janë me statut të banorëve jo-rezident apo që janë jashtë vendit.

Analizuar sipas kategorive të shërbimeve, amviseritë e përbejnë numrin më të madhë të klientëve, pastaj vijnë bizneset dhe industritë dhe në fund institucionet.

Numri i klientëve në të njëjtën periudhë të vitit 2022 ka qenë 24,389 klientë, prej tyre 4,708 klientë me status të banorëve jo-rezident apo që janë jashtë vendit.

Viti	Klientët aktiv të faturuar
2022	24,389
2023	32,343
Rritja	7,954

Siç shihet në tabelën më lartë, në vitin 2023 apo më mirë të themi në periudhën krahasuese Janar-Dhjetor 2022/2023 kemi rritje prej 32.61 % apo shprehur në numër prej 7,954 klientëve.

Në tabelën më poshtë mund të shihni ndarjen e klientëve nëpër njësitë punuese të KRM “Pastërtia” Sh.A. si dhe kategorinë e klientëve për secilën njësi.

Njësia operative	Amvisëri	Klientë jo-rezident	Biznese të rregullta	Biznese me kontratë	Institucionet	Gjithsej
Ferizaj	15934	5147	1882	433	70	23466
Kaqanik	3918	801	218	63	36	5036
Shtime	3217	279	261	53	31	3841
Gjithsej	23,069	6,227	2361	549	137	32,343

Nese behet krahasimi me planin e biznesit, kemi planifikuar që për vitin 2023 të kemi 33,800 klientë deri në perfundim të vitit kalendarik, 30,000 nga ta në sektorin e amviserisë. Ndërsa në këtë periudhë të raportimit kemi të regjistruar 32,343 apo shprehur në përqindje kemi arritur të regjistrojmë në databazë 95.69 % të klientëve të planifikuar për vitin 2023. Në sektorin e amviserise kemi arritur të regjistrojmë 29,296 apo shprehur në përqindje kemi realizuar 97.65% të planifikimit, ndërsa në sektorin e bizneseve kemi arritur të regjistrojmë 2,910 kliente nga 3,800 sa është planifikuar në planin e biznesit për vitin 2023 ose shprehur në përqindje kemi realizuar 76.58% të planifikimit.

1. TË HYRAT

Në vazhdim të raportit do të prezantojmë të hyrat për vitit 2023 si dhe krahasimin me të hyrat e periudhës së njëjtë të vitit 2022.

Të hyrat për periudhën Janar - Dhjetor 2022/2023 janë si në vijim:

Nr	Kategoritë e të hyrave	2023	2022	Ndryshimi	%
1	Të hyrat nga amvisëritë -Ferizaj	1,280,231.06	901,797.40	378,433.66	41.96%
2	Të hyrat nga amvisëritë -Shtime	221,416.29	166,305.37	55,110.92	33.14%
3	Të hyrat nga amvisëritë -Kaçanik	273,118.98	202,030.61	71,088.37	35.19%
4	Të hyrat nga biznesi-Ferizaj	264,031.24	193,626.24	70,405.00	36.36%
5	Të hyrat nga biznesi-Shtime	36,390.29	26,761.49	9,628.80	35.98%
6	Të hyrat nga biznesi-Kaçanik	28,463.83	22,986.71	5,477.12	23.83%
7	Të hyrat me kontrata-Ferizaj	138,087.66	100,385.76	37,701.90	37.56%
8	Të hyrat me kontrata-Shtime	23,642.63	17,758.17	5,884.46	33.14%
9	Të hyrat me kontrata-Kaçanik	30,537.14	19,757.65	10,779.49	54.56%
10	Të hyrat nga institucionet-Ferizaj	459,253.75	334,322.24	124,931.51	37.37%
11	Të hyrat nga institucionet-Shtime	25,968.11	58,124.10	-32,155.99	-55.32%
12	Të hyrat nga institucionet-Kaçanik	56,216.45	32,409.81	23,806.64	73.46%
13	Te ardhurat tjera financiare	-	3,118.82	-3,118.82	N/A %
Gjithsej të hyrat		2,837,357.44	2,079,384.37	757,973.07	36.45 %

Kjo tabelë paraqet të hyrat e realizuara në nivel regional, ku të hyrat e vitit 2023 kanë shënuar rritje prej 36.45 % në krahasim me periudhën e njëjtë të raportimit për vitin 2022. Kjo rritje është si rezultat edhe i ndryshimit të tarifave nga rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave nga Tetori i vitit 2022 në komunën e Ferizajt dhe të Kaçanikut, ndërsa nga muaji Prill i vitit 2023 në komunën e Shtimes.

Sa i përket kategorive të tjera të faturimit që shihet nga tabela e paraqitur duket kështu:

Të hyrat nga amvisëritë në këtë periudhë të raportimit në Ferizaj kanë qenë më të larta për 41.96% apo shprehur në vlerë 378,433.66€.

Të hyrat nga amvisëritë në këtë periudhë të raportimit në Njësinë Shtime kanë shënuar rritje për 33.14 % apo shprehur në vlerë monetare 55,110.92 € në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Ndërsa të hyrat nga amvisëritë në këtë periudhë të raportimit në Njësinë Kaçanik janë më të larta për 35.19% apo shprehur në vlerë monetare 71,088.37 € në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

E njejta situatë për sa i përket ndryshimit pozitiv në të hyrat e gjeneruara ku kemi pasur rritje, vlenë edhe për bizneset me tarifa të rregullta fikse si dhe ato me kontratë, kjo rritje e lartë vije si

rezultat i ndryshimit të tarifave nga Kuvendet Komunale të njësive në fjalë (Ferizaj, Kaçanik) përjashtuar Njësine Shtime ku ndryshimi i tarifave është aplikuar nga muaji Prill.

Të hyrat nga instuticionet

Sa i përket të hyrave nga instuticionet, në Njësine Ferizaj kemi rritje të të hyrave për 37.37%, ndërsa në njësine punuese Kaçanik kemi rritje të të hyrave prej 73.46%. Në njësine punuese në Shtime siç mund të shihet në tabelën më lartë kemi ulje të të hyrave prej -55.32%, ndryshim ky i cili vije si pasojë e mos arritjes të një marrëveshje për mirëmbajtjen e shesheve dhe hapsirave publike me këtë Komunë, njësoj siç kemi pasur në të njëjtën periudhë të viteve të kaluara.

Nëse i krahasojmë të hyrat e realizuara për periudhën Janar – Dhjetor 2023 me ato të planifikuara në Planin e Biznesit 2023-2025 atëherë po e prezentojmë tabelën si më poshtë:

Nr	Kategoritë e të hyrave	Të planifikuara Janar-Dhjetor 2023	Të Realizuara Janar-Dhjetor 2023	Diferenca	%
1	Të hyrat nga amvisëritë -Ferizaj	1,051,273.65	1,280,231.06	228,957.41	121.78%
2	Të hyrat nga amvisëritë -Shtime	261,590.00	221,416.29	-40,173.71	84.64%
3	Të hyrat nga amvisëritë -Kaçanik	323,200.00	273,118.98	-50,081.02	84.50%
4	Të hyrat nga biznesi-Ferizaj	186,850.00	264,031.24	77,181.24	141.31%
5	Të hyrat nga biznesi-Shtime	37,370.00	36,390.29	-979.71	97.38%
6	Të hyrat nga biznesi-Kaçanik	23,735.00	28,463.83	4,728.83	119.92%
7	Të hyrat me kontrata-Ferizaj	116,453.00	138,087.66	21,634.66	118.58%
8	Të hyrat me kontrata-Shtime	12,625.00	23,642.63	11,017.63	187.27%
9	Të hyrat me kontrata-Kaçanik	14,443.00	30,537.14	16,094.14	211.43%
10	Të hyrat nga instuticionet-Ferizaj	537,409.89	459,253.75	-78,156.14	85.46%
11	Të hyrat nga instuticionet-Shtime	29,391.00	25,968.11	-3,422.89	88.35%
12	Të hyrat nga instuticionet-Kaçanik	31,562.50	56,216.45	24,653.95	178.11%
Totali		2,625,903.04	2,837,357.44	211,454.40	108.05%

Nga tabela e paraqitur më lartë shihen se të hyrat kanë tejkaluar planifikimin e bërë për periudhën 2023-2025 si rezultat i angazhimit maksimal nga ana e stafit punues të KRM “Pastërtia” Sh.A. por edhe rritjes së tarifave nga Kuvendet Komunale të njësive punuese.

Në tabelën më poshtë po ju prezentojmë të hyrat e përgjithshme të ndara në bazë mujore për secilen njësi të KRM “Pastërtia” Sh.A.

Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Ferizaj	140,199	140,896	142,908	142,379	206,263	184,057	187,385	191,442	207,625	198,883	223,667	175,898
Shtime	20,151	20,191	20,236	26,851	27,308	27,443	26,625	26,709	28,055	27,915	27,934	27,999
Kaqanik	28,369	29,847	32,908	32,108	31,201	31,580	34,416	34,357	33,473	33,893	33,150	33,034
Totali	188,750	190,935	196,052	201,385	264,797	243,074	248,410	252,483	269,112	260,663	284,751	236,945

Objektivat tona me Plan të Biznesit për vitin 2024 janë rritja më e madhe e konsumatorëve duke kryer shërbime cilësore në kohë dhe hapësirë. Mbetet si detyrë dhe obligimi i yni që t'i marrim të gjitha masat e duhura, sa janë mundësitë dhe kapacitete tona ekzistuese që të kryejmë shërbime sa më të mira duke i plotësuar kërkesat e klientëve dhe të bëjmë përpjekje maksimale që ankesat e klientëve qofshin ato teknike apo komerciale t'i zvoglojmë në minimum dhe kështu t'i rrisim të hyrat tona buxhetore të cilat do të mundësojnë një afarizëm më rentabil.

2. INKASIMI

Me rritjen e numrit të klientëve është rritur edhe numri i faturave dhe vlera e faturave. Numri i faturave për periudhën shtator të vitit 2023 ka pasur rritje prej 7,954 faturave ose 32.61% rritje nga Janari 2023.

Gjithashtu dhe vlera e faturave për vitin 2023 ka arritur vlerën **2,837,357.44 €** me rritje prej **757,973.07 €** ose **36.45 %** në krahasim me vitin 2022 e që vlera e faturave ishte **2,079,384.37 €**.

	2022	2023	Diferanca	Dif. Në %
Numri i klientëve të faturuar	24,389	32,343	7,954	32.61 %
Vlera e faturave	2,079,384.37 €	2,837,357.44 €	757,973.07 €	36.45 %

Në përgjithësi, inkasimi për të gjitha njësitë Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime nga të gjithë sektorët për periudhën vjetore 2023 ka arritur vlerën prej 2,399,882.26€ në krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2022 që ishte 1,943,260.53 EUR, ku shënoi rritje prej 456,621.73 EUR ose një rritje prej 23.50% nga viti 2022.

Muaji	Njesia e Likujdimit	Njesia Ferizaj, Kaçanik, Shtime			
		Total inkasimi 2022	Total inkasimi 2023	Dif. në Vlere	Dif. në %
Total Sektori Privat	Arka	430,994.72	689,131.01	258,136.29	59.89%
	Banka	13,211.99	20,682.15	7,470.16	56.54%
	Inkasante	607,585.97	710,501.29	102,915.32	16.94%
	Total	1,051,792.68	1,420,314.45	368,521.77	35.04%
Total Sektori Biznes i vogël	Arka	34,950.34	40,811.05	5,860.71	16.77%
	Banka	8,824.28	11,757.00	2,932.72	33.23%
	Inkasante	169,486.75	227,640.94	58,154.19	34.31%
	Total	213,261.37	280,208.99	66,947.62	31.39%
Total Sektori Biznes i Madh	Arka	21,332.87	36,238.71	14,905.84	69.87%
	Banka	57,768.54	59,140.89	1,372.35	2.38%
	Inkasante	60,181.40	72,846.14	12,664.74	21.04%
	Total	139,282.81	168,225.74	28,942.93	20.78%
Total Sektori Shoqëror	Arka	192.31	954.25	761.94	396.20%
	Banka	545,348.03	530,178.83	-15,169.20	(2.78)%
	Inkasante	0	0	0.00	N/A
	Total	545,540.34	531,133.08	-14,407.26	(2.64)%
Total të Hyrat	Arka	487,470.24	767,135.02	279,664.78	57.37%
	Banka	625,152.84	621,758.87	-3,393.97	(0.54)%
	Inkasante	837,254.12	1,010,988.37	173,734.25	20.75%
	Total	1,949,877.20	2,399,882.26	450,005.06	23.08%

Rritja më e madhe për të gjitha njësitë Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime ishte në sektorin e amvisërisë me një rritje prej 35.04% ose e shprehur në vlerë monetare prej 368,521.77 €, pastaj duke vazhduar me sektorin biznes i vogël me rritje prej 31.39% dhe në fund me rritjen më të vogël e ka biznesi i madh me një rritje prej 20.78%. Ndërsa sektori shoqëror për të gjitha njësitë ka pasur rënie prej -14,407.26 € ose -2.64%, mirëpo të hyrat nga sektori shoqëror apo institucionet nuk varet nga performanca e kompanisë tonë KRM “Pastërtia” Sh.A., mirëpo kryesisht varet nga alokimet e mjeteve nga niveli qendror dhe bëhet në baza 3 mujore dhe niveli i borxhit nga komunat përkatëse.

Më poshtë do sqarojmë në detajë për secilin sektor dhe secilën njësi për performancën e tyre dhe mënyrës së alokimit të mjeteve përmes bankave, inaksantëve dhe arkave.

Raporti inkasimit për njësinë Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime për periudhën vjetore Janar – Dhjetor 2022 / 2023

Muaji	Ferizaj					Shtime					Kaçanik				
	Forma Inkasimi	Inkasimi 2022	Inkasimi 2023	Diferenca	%	Forma Inkasimi	Inkasimi 2022	Inkasimi 2023	Diferenca	%	Forma Inkasimi	Inkasimi 2022	Inkasimi 2023	Diferenca	%
Janar	Arka	26,181.62	50,538.53	24,356.91	93.03%	Arka	10,596.38	13,298.75	2,702.37	25.50%	Arka	3,285.95	5,248.50	1,962.55	59.73%
	Banka	2,740.31	4,727.49	1,987.18	72.52%	Banka	268.02	694.76	426.74	159.22%	Banka	11,938.15	1,244.77	(10,693.38)	-89.57%
	Inkasant	38,430.52	53,992.17	15,561.65	40.49%	Inkasant	7,745.07	6,113.52	(1,631.55)	-21.07%	Inkasant	13,869.19	17,276.67	3,407.48	24.57%
	Total	67,352.45	109,258.19	41,905.74	62.22%	Total	18,609.47	20,107.03	1,497.56	8.05%	Total	29,093.29	23,769.94	(5,323.35)	-18.30%
Shkurt	Arka	26,678.11	42,943.61	16,265.50	60.97%	Arka	5,286.38	6,258.54	972.16	18.39%	Arka	2,758.50	4,322.90	1,564.40	56.71%
	Banka	22,796.50	83,356.30	60,559.80	265.65%	Banka	354.13	2,233.48	1,879.35	530.69%	Banka	1,398.07	1,255.04	-143.03	-10.23%
	Inkasant	44,919.54	52,442.02	7,522.48	16.75%	Inkasant	6,505.39	5,175.44	-1,329.95	-20.44%	Inkasant	12,754.11	13,706.17	952.06	7.46%
	Total	94,394.15	178,741.93	84,347.78	89.36%	Total	12,145.90	13,667.46	1,521.56	12.53%	Total	16,910.68	19,284.11	2,373.43	14.04%
Mars	Arka	28,812.17	44,807.79	15,995.62	55.52%	Arka	5,231.18	7,778.85	2,547.67	48.70%	Arka	2,900.20	6,413.13	3,512.93	121.13%
	Banka	135,702.31	84,079.98	-51,622.33	-38.04%	Banka	13,958.25	5,057.21	-8,901.04	-63.77%	Banka	1,886.85	1,610.00	-276.85	-14.67%
	Inkasant	47,992.12	64,907.54	16,915.42	35.25%	Inkasant	7,609.75	5,963.92	-1,645.83	-21.63%	Inkasant	15,101.11	15,234.22	133.11	0.88%
	Total	212,506.60	193,795.31	-18,711.29	-8.81%	Total	26,799.18	18,799.98	-7,999.20	-29.85%	Total	19,888.16	23,257.35	3,369.19	16.94%
Prill	Arka	22,971.53	42,200.03	19,228.50	83.71%	Arka	5,121.65	6,427.60	1,305.95	25.50%	Arka	2,470.05	5,310.29	2,840.24	114.99%
	Banka	42,066.95	11,159.52	-30,907.43	-73.47%	Banka	8,166.19	1,945.53	-6,220.66	-76.18%	Banka	3,087.37	6,430.65	3,343.28	108.29%
	Inkasant	39,989.18	50,672.43	10,683.25	26.72%	Inkasant	7,252.15	6,319.81	-932.34	-12.86%	Inkasant	13,404.41	15,565.62	2,161.21	16.12%
	Total	105,027.66	104,031.98	-995.68	-0.95%	Total	20,539.99	14,692.94	-5,847.05	-28.47%	Total	18,961.83	27,306.56	8,344.73	44.01%
Maj	Arka	28,755.54	42,858.01	14,102.47	49.04%	Arka	5,500.50	7,616.36	2,115.86	38.47%	Arka	2,548.45	4,804.94	2,260.99	88.72%
	Banka	13,676.89	9,526.61	-4,150.28	-30.35%	Banka	6,115.45	3,866.87	-2,248.58	-36.77%	Banka	693.85	1,959.96	1,263.11	182.04%
	Inkasant	45,585.86	58,543.42	12,957.56	28.42%	Inkasant	6,516.93	9,702.63	3,185.70	48.88%	Inkasant	13,976.91	18,237.91	4,261.00	30.49%
	Total	88,018.29	110,928.04	22,909.75	26.03%	Total	18,132.88	21,185.86	3,052.98	16.84%	Total	17,219.21	25,004.31	7,785.10	45.21%
Qershor	Arka	24,121.62	37,128.15	13,006.53	53.92%	Arka	5,331.01	8,456.92	3,125.91	58.64%	Arka	2,852.27	4,958.53	2,106.26	73.85%
	Banka	15,370.25	12,652.50	-2,717.75	-17.68%	Banka	5,888.55	1,643.51	-4,245.04	-72.09%	Banka	2,620.82	3,961.04	1,340.22	51.14%
	Inkasant	45,864.49	60,211.40	14,346.91	31.28%	Inkasant	5,517.64	7,665.09	2,147.45	38.92%	Inkasant	12,612.21	17,467.17	4,854.96	38.49%
	Total	85,356.36	109,992.05	24,635.69	28.86%	Total	16,737.20	17,765.52	1,028.32	6.14%	Total	18,085.30	26,387.04	8,301.74	45.90%
Korrik	Arka	34,300.48	57,465.05	23,164.57	67.53%	Arka	8,172.85	11,441.65	3,268.80	40.00%	Arka	4,489.80	7,928.45	3,438.65	76.59%
	Banka	76,863.08	119,885.61	43,022.53	55.97%	Banka	6,497.45	3,761.28	-2,736.17	-42.11%	Banka	558.79	4,363.46	3,804.67	680.88%
	Inkasant	53,555.24	65,049.87	11,494.63	21.46%	Inkasant	7,007.59	6,972.04	-35.55	-0.51%	Inkasant	15,685.34	13,933.27	-1,752.07	-11.17%
	Total	164,718.80	242,400.53	77,681.73	47.16%	Total	21,677.89	22,174.97	497.08	2.29%	Total	20,733.93	26,225.18	5,491.25	26.48%
Gusht	Arka	38,989.24	71,400.95	32,411.71	83.13%	Arka	8,251.45	17,710.01	9,458.56	114.63%	Arka	5,234.95	9,355.95	4,121.00	787.00%
	Banka	43,636.71	17,634.53	-26,002.18	-59.59%	Banka	2,944.06	2,064.38	-879.68	-29.88%	Banka	5,240.49	3,671.99	-1,568.50	-29.93%
	Inkasant	51,912.20	72,239.06	20,326.86	39.16%	Inkasant	7,977.81	10,580.51	2,602.70	32.62%	Inkasant	18,658.99	17,532.47	-1,126.52	-6.04%
	Total	134,538.15	161,274.54	26,736.39	19.87%	Total	19,173.32	30,354.90	11,181.58	58.32%	Total	29,134.43	30,560.41	1,425.98	4.89%
Shtator	Arka	29,935.10	48,467.07	18,531.97	61.91%	Arka	6,777.02	10,240.68	3,463.66	51.11%	Arka	4,176.90	6,656.88	2,479.98	59.37%
	Banka	6,401.50	9,842.39	3,440.89	53.75%	Banka	4,820.13	2,703.74	-2,116.39	-43.91%	Banka	3,191.08	5,478.20	2,287.12	71.67%
	Inkasant	47,210.87	58,580.01	11,369.14	24.08%	Inkasant	8,198.01	12,079.37	3,881.36	47.35%	Inkasant	16,333.23	18,935.59	2,602.36	15.93%
	Total	83,547.47	116,889.47	33,342.00	39.91%	Total	19,795.16	25,023.79	5,228.63	26.41%	Total	23,701.21	31,070.67	7,369.46	31.09%
Tetor	Arka	30,286.68	35,360.45	5,073.77	16.75%	Arka	6,501.05	8,396.55	1,895.50	29.16%	Arka	3,092.55	5,152.40	2,059.85	66.61%
	Banka	93,898.37	94,215.98	317.61	0.34%	Banka	7,425.69	4,128.61	-3,297.08	-44.40%	Banka	8,177.65	10,780.63	2,602.98	31.83%
	Inkasant	46,439.71	39,186.42	-7,253.29	-15.62%	Inkasant	8,597.72	9,230.72	633.00	7.36%	Inkasant	13,952.20	21,908.55	7,956.35	57.03%
	Total	170,624.76	168,762.85	-1,861.91	-1.09%	Total	22,524.46	21,755.88	-768.58	-3.41%	Total	25,222.40	37,841.58	12,619.18	50.03%
Nentor	Arka	32,409.65	43,802.69	11,393.04	35.15%	Arka	6,194.01	8,776.96	2,582.95	41.70%	Arka	2,848.40	7,470.19	4,621.79	162.26%
	Banka	9,374.12	9,547.32	173.20	1.85%	Banka	4,063.76	3,216.82	-846.94	-20.84%	Banka	5,694.68	7,758.27	2,063.59	36.24%
	Inkasant	54,139.65	66,436.19	12,296.54	22.71%	Inkasant	6,897.90	7,584.33	686.43	9.95%	Inkasant	13,089.81	15,690.62	2,600.81	19.87%
	Total	95,923.42	119,786.20	23,862.78	24.88%	Total	17,155.67	19,578.11	2,422.44	14.12%	Total	21,632.89	30,919.08	9,286.19	42.93%
Dhjetor	Arka	40,183.16	55,643.20	15,460.04	38.47%	Arka	10,023.73	13,156.51	3,132.78	31.25%	Arka	4,200.11	7,333.45	3,133.34	74.60%
	Banka	32,926.30	63,584.22	30,657.92	93.11%	Banka	12,911.32	6,089.78	-6,821.54	-52.83%	Banka	11,798.75	15,629.44	3,830.69	32.47%
	Inkasant	58,382.07	66,796.47	8,414.40	14.41%	Inkasant	6,821.68	8,446.66	1,624.98	23.82%	Inkasant	16,747.52	20,608.77	3,861.25	23.06%
	Total	131,491.53	186,023.89	54,532.36	41.47%	Total	29,756.73	27,692.95	-2,063.78	-6.94%	Total	32,746.38	43,571.66	10,825.28	33.06%
TOTAL	Arka	363,624.90	572,615.53	208,990.63	57.47%	Arka	82,987.21	119,559.38	36,572.17	44.07%	Arka	40,858.13	74,960.11	34,101.98	83.46%
	Banka	495,453.29	520,212.45	24,759.16	5.00%	Banka	73,413.00	37,405.97	-36,007.03	-49.05%	Banka	56,286.55	64,140.45	7,853.90	13.95%
	Inkasant	574,421.45	709,057.00	134,635.55	23.44%	Inkasant	86,647.64	95,834.04	9,186.40	10.60%	Inkasant	176,185.03	206,097.03	29,912.00	16.98%
	Total	1,433,499.64	1,801,884.98	368,385.34	25.70%	Total	243,047.85	252,799.39	9,751.54	4.01%	Total	273,329.71	345,197.89	71,868.18	26.29%

Raporti inkasimi në raport me vlerën e faturës mujore Janar-Dhjetor 2023

Muaji	Te hyrat	Inkasimi	Diferenca	% e inkasimit
Janar	188,750	153,135.16	-35,614.84	81.14%
Shkurt	190,935	211,693.50	20,758.50	110.87%
Mars	196,052	235,852.64	39,800.64	120.30%
Prill	201,385	146,031.48	-55,353.52	72.53%
Maj	264,797	157,118.21	-107,678.79	59.34%
Qershor	243,074	154,144.61	-88,929.39	63.41%
Korrik	248,410	290,800.68	42,390.68	135.86%
Gusht	252,483	222,189.85	-30,293.15	87.99%
Shtator	269,112	172,983.93	-96,128.07	64.27%
Tetor	260,663	228,360.31	-32,302.69	87.60%
Nentor	284,751	170,283.39	-114,467.61	59.80%
Dhjetor	236,945	257,288.50	20,343.50	108.59%
Total	2,837,357.44	2,399,882.26	-437,475.18	84.58%

Me rritjen e numrit të klientëve dhe tarifave është rritur edhe numri i të hyrave brenda kompanisë KRM “Pastërtia” me vlerë prej **757,973.07 €** ose 36.45%. Në periudhën e vitit 2022 inkasimi i të hyrave total për këtë periudhë ishte **1,949,877.20 €** ndërsa në vitin 2023 shuma e arkëtuar e mjeteve është më e madhe e cila ka arritur vlerën në **2,399,882.26 €**, në krahasim me vitin 2022 inkasimi është më i lartë për 450,005.06 €

Sa i përket përqindjes së inkasimit në krahasim me faturimin mujorë në vitin 2023 mund të vërehet që grevat/ protestat e puntorëve kanë ndikuar dhe në zvogëlim apo rënje të inkasimit mujor për atë periudhë, ku grevat e shpeshta dhe mos kryerja apo ofrimit të shërbimit nga ana e kompanisë ka ndikuar edhe në mos pagesën e faturave mujore.

Nga këto të dhëna mund të vërehet total inkasimi në raport me faturimet për vitin 2023 është 84.58%, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitin 2022 ishte 93.45%. Në këto rezultate kanë ndikuar edhe sfidat me greva dhe protesta nga ana e puntorëve të kompanisë, ku kjo ka ndokur direkt në mos pagesën e faturës konkretisht në periudhat e njëjta kur është mbajtur greva dhe protesta. Duke pasur parasysh situatën e grevave dhe protestave në vitin 2023 dhe mos ofrimin e asnjë kampanje themi se arritja e inkasimit për 84.58% në vitin 2023 është e kënaqshme dhe dallimi nga viti i kaluar 2022 është vetëm 8.87% më i ulët. Në Mars të vitit 2023 kompania ka krijuar dhe futur në fuqi rregulloren për politikën dhe procedurat për menaxhimin e inkasimeve dhe borxheve të KRM “Pastërtia” SH.A., duke ofruar edhe bonusat për inkasntët për 15% për cdo euro të inkasuar mbi vlerën e faturës mujore, kjo sigurisht ka ndikuar pozitivisht pasi është rritur efikasiteti i inkasantave për inkasim sa më të madh të mjeteve dhe borxhëve të trashëguara.

3. SHPENZIMET

Një ndër faktorët kryesorë të analizës financiare të kompanisë, është edhe analiza e shpenzimeve që ka kompania gjatë aktivitetit të sajë. Në vazhdim po i paraqesim shpenzimet e krijuara për periudhën vjetore.

Shpenzimet për periudhën Janar – Dhjetor 2022/2023

Shpenzimet sipas llojit	2022	2023	Ndryshimi	%
Shpenzimet e Derivateve (1)	235,970.75	201,819.79	-34,150.96	-(14.47)%
Shpenzimet e higjenes dhe byfes (2)	2,093.87	2,279.45	185.58	8.86%
Shpenzimet e Energjise Elektrike	5,373.18	5,942.35	569.17	10.59%
Shpenzimet uji	474.66	188.69	-285.97	-(60.25)%
Blerje/Shpenzime te tjera (3)	26,763.81	32,179.32	5,415.51	20.23%
Shpenzimet per antarsi Pamkos	4,800.00	4,800.00	0.00	N/A
Mirmbajtje dhe riparime (4)	86,284.35	35,360.34	-50,924.01	-(59.02)%
Shpenzimet per goma (5)	2,925.66	13,573.09	10,647.43	363.93%
Kontrollimi teknik i automjeteve	3,097.46	1,025.42	-2,072.04	-(66.89)%
Sigurime per automjete	9,684.47	7,193.54	-2,490.93	-(25.72)%
Takse administrative	4,807.99	1,155.00	-3,652.99	-(75.98)%
Takse rrugore	2,428.00	1,840.00	-588.00	-(24.22)%
Takse Ekologjike	808.00	610.00	-198.00	-(24.50)%
Takse komunale	571.00	408.00	-163.00	-(28.55)%
Sherbime kontaktuale (6)	56,783.30	27,823.03	-28,960.27	-(51.00)%
Deponia KMDK	207,507.17	265,900.12	58,392.95	28.14%
Web faqe, reklama (7)	1,491.60	2,408.40	916.80	61.46%
Transferime, udhetime, reprezentacion	2,422.91	686.19	-1,736.72	-(71.68)%
Shpenzime internet dhe telefon	7,946.07	7,244.14	-701.93	-(8.83)%
Provizion banker	9,998.89	7,522.36	-2,476.53	-(24.77)%
Taksa Regjistrimit	185.00	0	-185.00	N/A
Tatim ne prone Ferizaj	0	528.76	528.76	N/A
Tatim ne prone Shtime	423.07	187.92	-235.15	-(55.58)%
Pagat dhe shperblimet e personelit (8)	1,323,522.40	1,471,320.75	147,798.35	11.17%
Kontributet Pensionale te Ndermarrjes	66,176.12	73,398.24	7,222.12	10.91%
Shpenzime të tjera për personelin (9)	3,405.00	4,379.28	974.28	28.61%
Shpenzimet e qirasë (10)	13,250.00	10,500.00	-2,750.00	-(20.75)%
Shpenzimet per perfaqesime	1,147.50	967.00	-180.50	-(15.73)%
Gjoha dhe demshperblime	2,478.22	5,000.00	2,521.78	101.76%
Shp. Administrative & Fin. te tjera (11)	15,152.36	24,231.75	9,079.39	59.92%
Shpenzimet e mirembajtjes programit	11,760.00	6,800.00	-4,960.00	-(42.18)%
Ndihma Solidare	156.00	800.00	644.00	412.82%
Shpenzimet qe nuk i njeh ATK (Kamata)	912.52	0	-912.52	N/A
Gjithsej shpenzime	2,110,801.33	2,218,072.93	107,271.60	5.08%

Shpenzimet për periudhën vjetore 2023 kapin shumën prej **2,218,072.93 €**, ndërsa shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar ishin **2,110,801.33 €** që tregon se shpenzimet e kësaj periudhe janë më të mëdha për **107,271.60 €** a po shprehur në përqindje për 5.08 %. Nëse i marrim parasysh të gjitha elementet që kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve, atëherë rritja e shpenzimeve prej 5.08% tregon se menaxhmenti është munduar maksimalisht të minimizoj shpenzimet kur dihet se kriza globale ekonomike ka bërë që çmimet e disa produkteve të dyfishohen siç janë: çmimi i derivateve, i hekurit, vajit, etj.

Siç mund të vërehet në tabelën më lartë ku shpenzimet janë të përgjithësuara në zëra kontabël, shpenzimet që vërehen se kanë rritje të lartë në krahasim me periudhën e njëjtë krahasuese janë ato të pagave dhe shpenzimeve për sigurimet shoqërore ku vlera e tyre është rritur për 155,020.50€ në krahasim me periudhën e njëjtë të deklarimit, pastaj vijnë shpenzimet e KMDK-së (deponisë së mbeturinave), ku për këtë periudhë janë shpenzuar 265,900.12 euro. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ku shpenzimet ishin 207,507.17 euro. Siç shihet diferenca është -58,392.95 euro, apo shprehur në përqindje 28.14% më shumë shpenzime për deponi në vitin 2023 se sa në atë të vitit 2022.

Shpenzimet administrative dhe financiare tjera janë dy zëra kontabël të fuzionuara në një vend, dhe siç mund të vërehet rritja prej 59.92% e këtyre shpenzimeve vërtet si shkak i pajisjes me një printer me veti industriale i cili nevojitet për shtypjen e faturave dhe shënimeve tjera për punonjësit e KRM “Pastërtia” Sh.A. nevojë kjo e shprehur kahmotshëm nga punonjësit, si dhe arsye tjetër për rritjen e vlerë së këtij zëri është edhe furnizimi me pajisje material të shtypur për nevojat e KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj, në bazë të kontratës me operatorin ekonomik i cili ka kryer furnizimin, me ç’rast kontrata për furnizim ka arritur afatin kohor por jo edhe financiar të saj, kështu është dashur të porositet material i shtypur më shumë për të mbajtur si rezerv në mënyrë që të përmbushet edhe kontrata por edhe mos të mbetet kompania me mungesë të këtyre materialeve.

Shpenzim tjetër i lartë i cili vlenë të cekët është edhe furnizimet me derivate, arsyeja e rritjes së këtyre shpenzimeve është lëvizja e çmimeve në bursë por edhe shtimi i makinerive të cilat operojnë në kuadër të trija njësisve të KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj, e që në periudhën e njëjtë krahasuese të vitit të kaluar, KRM “Pastërtia” Sh.A. ka operuar me 15 kamionë më pakë, pasi që në Gusht të vitit 2022 kemi pranuar 9 kamionë donacion nga Qeveria Japoneze, 5 kamion nga KFW dhe 1 Kamion nga GiZ, dhe si të tillë operimin e tyre e kanë filluar në muajin Shtator 2022.

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në vitin 2022 ishin 86,284.35 euro ndërsa në vitin 2023 janë 35,360.34 euro që nënkupton kemi ulje të shpenzimeve për -(59.02)% si arsye e angazhimit të madhë të mekanikëve për rregullimin e makinerisë, si dhe pajisja me kamionë të rinjë nga Qeveria Japoneze dhe KFW.

Përpos rritjes së shpenzimeve në disa zëra, menaxhmenti i KRM “Pastërtia” Sh.A. Ferizaj ka arritur edhe të minimizojë disa shpenzime tjera në krahasim me periudhën krahasuese në këtë raport. Vlenë të cekën shpenzimet e mirëmbajtjes së makinerive të cilat janë ulur për mbi 50 mijë euro apo shprehur në përqindje për -59% pasi që furnizimi me kamionë të rinjë i ka ulur nevojat për riparime në krahasim me periudhën krahasuese, ku operimi i KRM “Pastërtia” Sh.A është kryer me numër të vogël të makinerive dhe mbi ngarkimi me punë i këtyre kamionëve qante në defekte më të shpeshta të tyre, pastaj shpenzimet për shërbime kontraktuale ku këtë periudhë janë më të

ulta për 28,960.27 mijë euro, apo shprehur në përqindje për -(51.00)%, pasi që me furnizimin me kamionë të rinjë nuk është shfaqur nevoja për angazhim të kompanive tjera apo marrjen e kamionëve të tjerë me qira, siç jemi detyruar të veprojmë në disa raste në të kaluarën.

Më poshtë janë të listuara edhe sqarimet për zëra të tjerë për këdo që e lexon këtë raport:

Sqarime:

- (1) Shpenzimet e derivateve janë të përmbledhura për të trija njësitë, nëse i ndajmë këto shpenzime për njësi veq e veq atëherë, për njësinë punuese Ferizaj janë shpenzuar 141,927.97 euro, për njësinë punuese Shtime janë shpenzuar 32,298.69 euro, ndërsa njësia Kaçanik ka shpenzuar 27,548.14 euro për derivate.
- (2) Shpenzimet e Higjienes dhe Byfese janë për 8.86% për arsye të ngritjes së çmimeve të produkteve të cilat i konsumojmë në Byfe dhe produktet e mirëmbajtjes së Higjienës.
- (3) Blerje/Shpenzime tjera janë më të larta për arsye në përfundim të kësaj periudhe është porositur material shtesë për mjete pune pasi që kontrata me operatorin ekonomik përfundonte në këtë periudhë prandaj është bërë porosi për përmbushje të kontratës dhe furnizim me produkte rezerv në depo në vlerë prej 3,720.34 €, si dhe furnizim me GPS për kamionët e rinjë përmes tenderit në vlerë prej 5,924.00 €.
- (5) Shpenzimet për goma janë më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar për arsye se në këtë periudhë të vitit 2022 nuk kemi pasë të kontraktuar operator ekonomik për furnizime me goma.
- (6) Shpenzimet kontraktuale në vitin 2022 janë shpenzime të larta për arsye të marrjes me qira të makinave për nevoja të barjtes së mbeturinave nga kompania në mungesë të kamionëve dhe shtimit të vëllimit të mbeturinave. Vlenë të theksohet edhe marrëveshja memorandum bashkëpunimit me kompaninë Mbrajotja e Ambientit (MeA) e cila kishte kryer shërbimin në 6 Fshatra të Ferizajit. Ndërsa në vitin 2023 Shpenzimet kontraktuale kanë qenë për angazhimin e një kontabilisti të certifikuar për certifikim e pasqyrave financiare si dhe auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare, angazhimin e një eksperti për vlerësimin e ndikimit në mjedis për pajisje me leje komunale për operim si dhe marrëveshja me kompani private për bartjen e mbeturinave gjatë periudhës së greves 2 javëshe nga ana e punëtorëve të Operativës gjatë muajit Tetor 2023.
- (7) Shpenzimet e Wep faqes, Reklamat janë më të larta në këtë periudhë të vitit 2023, për arsye se kemi pasur hapje më të shpeshta për konkurse të punës dhe kështu shpenzimet për publikimin e këtyre konkurseve kanë pasur koston e vet si dhe disa shpenzime relevante për urime të festave zyrtare në vend.
- (8) Rritjet më të larta të shpenzimeve në këtë periudhë shihet se janë tek pozicioni i shpenzimeve për paga, ku për shpenzimet e pagave në këtë vit kemi shpenzuar 1,544,718.99 euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2022 shpenzimet e pagave ishin 1,389,698.52 euro. Shpenzimet e pagave në këtë gjashtëmuajor kanë qenë më të larta për 155,020.47 euro, ose shprehur në përqindje 11.15 %. Kjo për arsye të rritjes së pages për disa sektorë të kompanisë.
- (9) Shpenzimet e tjera për personelin janë shpenzimet e realizuara për kompenzimin e ri-certifikimit të puntorit i cili manovron me makineri të rëndë si dhe kompenzimi për trajnimet e

Auditores së Brendshme, shpenzime këto të mbuluara me vendime të Bordit, gjithashtu edhe realizimi i kontrollave mjeksore për pajisje me çertifikatë mjeksore si dhe trajnimet për riskun në punw.

(10) Shpenzimet e Qirasë –Në të kaluarën është praktikuar njohja e shpenzimeve të qirasë në momentin kur është bërë pagesa për qiranë e shfrytëzuar, ndërsa së fundmi Zyra e Financave ka bërë njohjen e shpenzimeve të qirasë në bazë mujore dhe jo siç është praktikuar në të kaluarën.

(11) Shpenzimet administrative dhe financiare tjera janë dy zëra kontabël të fuzionuara në një vend, dhe siç mund të vërehet rritja prej 59.92% e këtyre shpenzimeve vërejt se shkak i pajisjes me një printer me veti industriale i cili nevojitet për shtypjen e faturave dhe shënimeve tjera për punonjësit e KRM “Pastërtia” Sh.A. nevojë kjo e shprehur kahmotshëm nga punonjësit, si dhe arsye tjetër për rritjen e vlerë së këtij zëri është edhe furnizimi me pajisje material të shtypur për nevoja të KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj, në bazë të kontratës me operatorin ekonomik i cili ka kryer furnizimin, me ç’rast kontrata për furnizim ka arritur afatin kohor por jo edhe financiar të saj, kështu është dashur të porositet material i shtypur më shumë për të mbajtur si rezerv në mënyrë që të përmbushet edhe kontrata por edhe mos të mbetet kompania me mungesë të këtyre materialeve.

(12) Në zërin ndihma solidarë hyjnë shpenzime simbolike kryesisht për raste vdekjesh familjarësh të të punësuarve në KRM “Pastërtia” Sh.A, si dhe ndihmë simbolike të një punëtori për ndërhyrje kirurgjikale mjeksore.

Në tabelën më poshtë në mënyrë të detajuar dhe të zgjeruar do të paraqesim zërat kontabël dhe shpërndarjen e transaksioneve të shpenzimeve.

Shpenzimet sipas llojit	2023	
Shpenzimet e Derivateve (1)	201,819.79	
Derivate Ferizaj		141,927.97
